



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.2156/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Parajsa shpk me numër unik identifikues 81096833 me seli në Lipjan, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Marigona Gashi avokate nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Lipjanit, me bazë juridike përmbarimore për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.647/24 të datës 23.10.2024, me datë 10.01.2025, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Lipjanit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.647/24 i datës 23.10.2024, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.647/24 të datës 23.10.2024, ka Refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Lipjanit, të paraqitur kundër urdhrit përmbarimor P.nr.135/24 të datës 12.02.2024, të përmbaruesit privat Bardh Tasholli dhe ka Lënë në fuqi Urdhrin përmbarimor P.nr.135/24 të datës 12.02.2024 të lejuar nga përmbaruesi privat Bardh Tasholli.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur debitori për shkak se faturën në të cilën thirret propozimi, debitori e ka kthyer tek kreditori ngase ishte pa raport dhe ka qenë e paspecifikuar se për cilat punë që i ka kryer tani kreditori kërkon shumën e cekur. Debitori e

kundërshton faturën sepse nuk e ka fuqinë e titullit ekzekutiv, dhe i propozon gjykatës që të aprovohet ankesa, të shfuqizohet urdhri përmbarem P.nr.135/24

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbareme (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Parajsa shpk me numër unik identifikues 81096833 me seli në Lipjan, me datë 12.02.2024, ka paraqitur propozim për përmbarem kundër debitorit Komuna e Lipjanit, në bazë të dokumentit të besueshëm - faturës nr.02/2023 të datës 16.08.2023, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 24.380,10 €.

Përmbaremi privat Bardh Tasholli, duke vepruar sipas propozimit për përmbarem të kreditorit me urdhrin përmbaremi P.nr.135/24 të datës 12.02.2024, ka lejuar përmbaremin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbarem.

Kundër këtij urdhri përmbaremi debitori ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbaremi, me arsyetimin se fatura në bazë të së cilës mbështetet propozimi për përmbarem është kthyer kreditorit sepse nuk ka raport dhe nuk thekson se cilat punë i ka kryer kreditori për të cilat kërkon edhe shumën e cekur, gjithashtu propozimit për përmbarem nuk ia ka bashkangjitur faturën, i propozon gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri për përmbarem.

Në përgjigje në prapësim kreditori i kundërshton pretendimet e debitorit, duke theksuar se në dosjen e lëndës ekziston specifikacioni për punët e kryera nga kreditori, ku e njëjta i është dorëzuar debitorit dhe se fatura i është bashkangjitur propozimit për përmbarem, ku edhe vet debitori i referohet të njëjtës në prapësim, i propozon gjykatës që prapësimin e debitorit të refuzoj si të pabazuar ndërsa urdhri përmbaremi të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.647/24 të datës 23.10.2024, në ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, dhe ka Lënë në fuqi Urdhrin përbarimor P.nr.135/24 të datës 12.02.2024.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar Dhoma e shkallës së parë, ka theksuar se përbaruesi privat ka lejuar urdhrin përbarimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm faturës nr.02/2023 dt.16.08.2023, faturë kjo e cila përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29 par.3 të LPP-së, po ashtu gjykata gjen se e njëjta faturë është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa është pranuar nga ana e debitorit qka vërtetohet nga vula mbi pranimin e shkresave. Bashkangjitur propozimit për përbarim, është situacioni për pagesë e nënshkruar nga menaxheri i kontratës dhe shkresa e datës 16.08.2023 e lëshuar nga Departamenti për Infrastrukturë e Komunës së Lipjanit, që rezulton se debitori ka qenë i njoftuar me kohë për detyrimin për pagesë sipas faturës.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përbaruesit privat, me të cilin është caktuar përbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përbarimi është lejuar në bazë të faturës nr.02/2023 datës 16.08.2023, në shumën prej 24,380.10 €, të lëshuar nga kreditori, dhe e noterizuar, e cila rezulton se është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, se fatura ligjërish paraqet bazë juridike për caktimin e përbarimit, e njëjta është e vulosur me nr. protokolit 14-370/01-70495 dt.28.12.2023, nga organi kompetent i debitorit, element ky bazë që shpreh vërtetësinë dhe autenticitetin e një dokumenti, se e njëjta është pranuar ne mënyrë të rregullt dhe është evidentuar ne regjistrat e institucionit. Kjo faturë e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm konform nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së dhe si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përbarimit, sepse i përmbajnë elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, i cili shprehimisht përcakton se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*, si dhe është në pajtim me nenin 37 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Kur propozimi për përbarim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimit ti*

*bashkëngjitet dokumenti i tillë ne original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*". Gjithashtu si provë që dëshmon se debitori ka pranuar borxhin ndaj kreditorit sipas faturës përbarimore dëshmohet edhe me shkresën e datës 16.08.2023 nga debitori-Departamenti për Infrastruktura e Komunes së Lipjanit drejtuar prokurimit.

Prandaj, bazuar në këto arsye, Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komeriale, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komeriale, Dhomat e Shkallës së Dytë analizoi pretendimet e debitorit por vlerëson se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë konkrete në mbështetje të tyre siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, ashtu që të njëjtat i refuzoi si të pabazuara. Në këtë rast gjykata nuk pranon pretendimet e debitorit se fatura nuk e ka fuqinë e titullit ekzekutiv. Dhomat e shkallës së dytë i konsideron vetëm si deklarata verbale pretendimet ankimore të debitorit, për shkak se fatura përbarimore e kreditorit, shkresa e datës 16.08.2023, raporti për pagesë dt.16.08.2023 të debitorit, dëshmojnë se debitori si institucion publik në këtë rast ka pranuar borxhin nga fatura bashkëngjitur propozimit për përbarim, dhe se fatura është dokument i besueshëm sikurse kërkohet me nenin 29 par.3 të LPP-së.

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi me rastin e kryerjes se përbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur me këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përbarimit në këtë rast.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.2156/2024 me datë 10.01.2025

Gjyqtari,  
Krenar Berisha